



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SPORTEVE TË TIRANËS
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1212/12 Prot.

Tiranë, më 11.09 2020.

V E N D I M

Nr. 38 dt. 11.09 2020

MBI NDRYSHIME NË VENDIMIN NR 10 DATË 04.02.2020”MBI MIRATIMIN E STRUKTURËS ORGANIZATIVE DHE ANALITIKE, DHE KLASIFIKIMIT TË PAGËS, PËR VITIN 2020”.

Në zbatim të pikës 1/ç, të nenit 49, të Ligjit nr. 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 123 datë 17.02.2010 “Për krijimin e Universitetit të Sporteve të Tiranës”, në Urdhërin e MASR me Nr.495, datë 11.10.2019 “Për hapjen e njësisë kryesore “Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit” në Universitetin e Sporteve të Tiranës”, VKM Nr.268, datë 29.03.2017 “Për disa ndryshime në VKM Nr.748, datë 11.06.2009 i ndryshuar “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të personelit akademik të institucioneve publike të Arsimit të Lartë”, VKM Nr.329, datë 12.04.2017 “Për statusin dhe trajtimin e veçantë të personelit akademik”, Vendimin e Senatit nr. 4 datë 09.09.2020, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Miratimin e ndryshimeve në Vendimin e BA nr. 10 datë 04.02.2020 “Mbi miratimin e Strukturës Organizative dhe Analitike dhe klasifikimit të pagës, për stafin e Universitetit të Sporteve të Tiranës, për vitin 2020”, sipas tabelave bashkëngjitur.
2. Efektet financiare të ndryshimeve mbulohen nga buxheti i Universitetit të Sporteve të Tiranës.
3. Ngarkohen Administratori, Njësitë kryesore, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Arkivës dhe Drejtoria e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në www.ust.edu.al dhe tek portali i transparencës universitare.

KRYETARI I BORDIT TË ADMINISTRIMIT

HYSEN DOMI



Tabela 1.

Nr.	Njësia	Kategoria	Sipas strukturës ishte	Behet
1	REKTORATI			
1.1		Personel akademik	Rektor (Dep. Shkenc.Soc.Ed. FSHL)	Rektor (Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit, FVFR)
		Personel akademik	Zv/ Rektor ana mësimore (FVFR, DVFR)	Zv/ Rektor ana mësimore (FSHL, DMS)
2	FAKULTETI I SHKENCAVE TË LËVIZJES			
2.1	Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit			
		Personel akademik	Rektor (Dep. Shkenc.Soc.Ed. FSHL	Profesor
2.2	Departamenti i Mjekësisë Sportive			
		Personel akademik	Profesor i Asociuar	Zv/Rektor, Profesor
3	FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT			
3.1	Departamenti i Vepr. Fizike, Rekreative dhe Turizmit			
		Personel akademik	Zv/ Rektor ana mësimore (FVFR, DVFR)	Profesor i Asociuar
3.2	Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit			
		Personel akademik	Drejtues Departamenti, Profesor	Drejtues Departamenti Doktor
		Personel akademik	Profesor	Rektor (Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit, FVFR)
4	INSTITUTI I KËRKIMIT SHKENCOR TË SPORTIT			
4.1	Departamenti Kërkimit Lëvizjes së Aplikuar			
		Personel akademik	Drejtues Departamenti Doktor	Drejtues Departamenti, Profesor
4.2	Departamenti i Kërkimit në Vep. Shënd& Rekreacionit			
		Personel akademik	Drejtues Departamenti, Profesor	Drejtues Departamenti Doktor

Mbështetur në shkresën e Dekanatit të FVFR Nr.1175 prot, dt. 03.09.2020 “Mbi kalimin në linjë paralele dy fonde pagash nga nga Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit në Departamentin e Veprimtarisë Fizike Rekreative e Turizmit”

Nr.	Njësia	Kategoria	Sipas strukturës ishte	Behet
3	FAKULTETI I VEPRIMTARISË FIZIKE DHE REKREACIONIT			
3.1	Departamenti i Vepr. Fizike, Rekreative dhe Turizmit			
		Personel akademik	As/ Lektor Nr.i punonjësve 4	As/ Lektor Nr.i punonjësve 6
3.2	Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit			
		Personel akademik	As/ Lektor Nr.i punonjësve 5	As/ Lektor Nr.i punonjësve 3